



VENDIM NR 02/22
I ORTAKUT TË VETËM
TE SHOQËRISË “BAMLLARI KONSTRUKSION” SHPK
Datë 28.12.2022

Sot, më 28.12.2022, u mbledh rregullisht mbledhja e Ortakut të Vetëm të shoqërisë BAMLLARI KONSTRUKSION SHPK, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, regjistruar në Regjistrin Tregtar të mbajtur pranë Qendrës Kombëtare e Biznesit, me seli ligjore në adresën: Rruga e Prezës, Pasuria me 177/9, Zona Kadastrale 3049, Vorë, Tiranë dhe me numër unik identifikimi të subjektit (NUIS): M22311031T (në vijim referuar si "Shoqëria"), për të diskutuar dhe vendosur lidhur me çështjet e rendit të ditës si vijon:

RENDI I DITES:

1. Miratimi i Kontratës së Shitblerjes të lidhur midis Shoqërisë “BAMLLARI KONSTRUKSION” SHPK dhe ortakut të vetëm z. Rolandi Bamllari për blerjen e Pasurisë së Paluajtshme e llojit Ullishte me Nr. Pasurie 373/50, Zona Kadastrale 3266, vol 14, faqe 185, me sipërfaqe totale 2,600 m², e ndodhur në Sauk, Tiranë, në vlerën EUR 350,000 (treqind e pesëdhjetë mijë Euro), kundërvlera në **ALL 39,490,500 (tridhjetë e nëntë milion e katërqind e nëntëdhjetë mijë e pesëqind Lekë)** konvertuar sipas kursit të këmbimit të Bankës së Shqipërisë me datë 28.12.2022 (1EUR=112.83ALL), me qëllim transferimin e titullit të pronësisë mbi Pasurinë të Shoqëria “BAMLLARI KONSTRUKSION” SHPK si kontribut në natyrë nga Ortaku i Vetëm për zmadhimin e kapitalit të Shoqërisë “BAMLLARI KONSTRUKSION” SHPK.
2. Të ndryshme.

Mbledhjen e kryesoi ortaku i vetëm i shoqërisë **Z. Rolandi Bamllari**, i cili konstatoi se mbledhja është e vlefshme, pasi asambleja është thirrur konform statutit të shoqërisë dhe është i pranishëm ortaku i vetëm, zotërues i të gjitha kuotave si më poshtë:

Z. Rolandi Bamllari, zotërues i **100 (njëqind)%** të kapitalit të Shoqërisë me vlerë **ALL 35,788,297 (tridhjetë e pesë milion e shtatëqind e tetëdhjetë e tetë mijë e dyqind e nëntëdhjetë e shtatë lekë)**, të cilat i korrespondojnë **1 (një) pjese me vlerë ALL 35,788,297 (tridhjetë e pesë milion e shtatëqind e tetëdhjetë e tetë mijë e dyqind e nëntëdhjetë e shtatë lekë)**.

Pasi analizuan dhe diskutuan çështjet e sipërpërmendura të Rendit të Ditës, Asambleja e Përgjithshme vendosi si në vijim:

VENDOSI:

1. Miratimin e Kontratës së Shitblerjes të lidhur midis Shoqërisë “BAMLLARI KONSTRUKSION” SHPK dhe ortakut të vetëm z. Rolandi Bamllari për blerjen e Pasurisë së Paluajtshme e llojit Ullishte me Nr. Pasurie 373/50, Zona Kadastrale 3266, vol 14, faqe 185, me sipërfaqe totale 2,600 m², e ndodhur në Sauk, Tiranë, në vlerën EUR 350,000 (treqind e pesëdhjetë mijë Euro), kundërvlera në **ALL 39,490,500 (tridhjetë e nëntë milion e katërqind e nëntëdhjetë mijë e pesëqind Lekë)**



konvertuar sipas kursit të këmbimit të Bankës së Shqipërisë me datë 28.12.2022 (1EUR=112.83ALL), me qëllim transferimin e titullit të pronësisë mbi Pasurinë të Shoqëria "BAMLLARI KONSTRUKSION" SHPK si kontribut në natyrë nga Ortaku i Vetëm për zmadhimin e kapitalit të Shoqërisë "BAMLLARI KONSTRUKSION" SHPK.

2. Zmadhimin e Kapitalit të Shoqërisë "BAMLLARI KONSTRUKSION" SHPK me vlerën ALL 39,490,500 (tridhjetë e nëntë milion e katërqind e nëntëdhjetë mijë e pesëqind Lekë) nëpërmjet kontributit në natyrë të ortakut të vetëm z. Rolandi Bamllari sipas pikës 1 të këtij Vendimi dhe kështu, kapitali i Shoqërisë "BAMLLARI KONSTRUKSION" SHPK bëhet **ALL 75,278,797 (shtatëdhjetë e pesë milion e dyqind e shtatëdhjetë e tetë mijë e shtatëqind e nëntëdhjetë e shtatë Lekë)**.
3. Autorizohet administratori i shoqërisë z. Rolandi Bamllari për nënshkrimin e Kontratës së Shitblerjes në pikën 1 si përfaqësues i Shoqërisë.
4. Autorizohet Administratori i Shoqërisë z. Rolandi Bamllari për të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për përditësimin pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit të të dhënave mbi kapitalin si rrjedhojë e transferimit, kompletimit dhe regjistrimit të kontributit të Ortakut të Vetëm Themelues në pronësi të shoqërisë.

Duke mos pasur çështje të tjera për të diskutuar, Kryetari i mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme e deklaroi mbledhjen të mbyllur.

Ky vendim bëhet efektiv menjëherë pas nënshkrimit të tij. Anëtarët konfirmojnë me nënshkrimet e tyre si vijon:

Z. Rolandi Bamllari

Bamllari
KONSTRUKSION
BAMLLARI KONSTRUKSION sh.p.k.
M22219043K